



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HERMANN GMEINER"

Nr. 2011/2 prot.

Tiranë, më 15.12.2021

Lënda: Njoftim për vend të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë,,"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.5.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesëve publikë të arsimit dhe formimit profesional",

Shkolla "Hermann Gmeiner" Tiranë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

- 1 mësimdhënës i teorisë profesionale TIK(Programim)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posacme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti për mësimdhënës të teorisë profesionale duhet të plotësojë kriteret e posacme si vijon:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me kualifikimin profesional të kërkuar;
- b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në);
 - c) kartën e identitetit;
 - d) diplomën;
 - e) librezën e punës;
 - f) cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
 - i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
 - j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
3. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopjo të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

4. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të shkollës, brenda datës 30.12.2021.

DREJTORE

Hedie Gjoni
Hedie Gjoni

